



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPSTINA VUCITRN	
01 Nr. / Br	33/25
Nr. i fq. / Br. sh	-1-
Data: / Datum	27.02.2025
VUSHTRRI - VUCITRN	



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja (d) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 6 të Rregullores 01Nr.209/20 e datës 29.10.2020 për Dhënien e Dekoratave, nenin 19 pika 1.4 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më **27 shkurt 2025**, merr këtë:

VENDIM PËR DHËNIEN E TITULLIT “NDERI I QYTETIT”

1. Me këtë vendim, më datë 24 mars “ditës së rënies”, me titull “Nderi i qytetit” (post mortum), nderohet z. Latif Berisha, për kontributin e dhënë për çështjen kombëtare, duke u bërë frymëzim për brezat e ardhshëm.
2. Dorëzimi i kësaj dekorate (titullit) do të bëhet nga Kryetari i Komunës, më datë 24 mars “ditës së rënies”.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, si dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRAN	
01 Nr. / Br.	34/25
Nr. i fq. / Br. sh.	- 1 -
Data: / Datum	27. 02. 2025
VUSHTRRI - VUČITRAN	



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës – Vushtrri

Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 36 paragrafi 1 të Rregullës Financiare të Ministrisë së Financave Nr. 01/2013 Shpenzimi i Parave Publike, nenin 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Statutit të Komunës, si dhe nenin 5 paragrafi 2 i Rregullores (KKV) Nr. 03/23 për Përcaktimin e Kriterëve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione Personave Juridikë – OJQ-ve dhe Ndihmë Momentale Personave Fizikë dhe Bashkëfinancim me numër të protokollit Nr. 49/23 datë 23.02.2023, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më **27 shkurt 2025** merr këtë:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

1. Me këtë vendim z. Rrahim Ajeti, kryetar i Këshillit të fshatit Stanoc i Poshtëm i ndahen mjete financiare në shumë prej tremijë euro (3,000.00 €), ndihmë financiare për rregullimin e kulmit të shtëpisë së komunitetit në fshatin Stanoc i Poshtëm.
2. Mjetet financiare të cekura si në pikën paraprake të këtij vendimi do të sigurohen nga buxheti i Komunës së Vushtrrisë, Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, kategoria subvencione dhe transfere, kodi i programit 470.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural si dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRAN	
01 Nr. / Br	35/25
Nr. i fq. / Br. st	-1-
Data: / Datum	27. 02. 2025
VUSHTRRI - VUČITRAN	



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2 të Ligjit për Vetëqeverisjen lokale (nr.03/L-040), dhe të nenit 19 pika 1.4 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më **27 shkurt 2025**, merr këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PROPOZIMIT TË KRYETARIT TË KOMUNËS PËR LIRIM NGA QIRAJA TË LOKALEVE AFARISTE NË SHESHIN "ADEM JASHARI"

1. Me këtë vendim miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës, për lirim nga qiraja për vitin 2022, 2023 dhe 2024 pronarët në shfrytëzim të lokaleve afariste, pronë komunale në sheshin "Adem Jashari" si në vijim:

- 1.1. Aziz Kolla qiramarrës i lokalit nr. 136
- 1.2. Fatmir Durguti qiramarrës i lokalit nr. 138
- 1.3. Ahmet Tërllabuqi qiramarrës i lokalit nr. 140
- 1.4. Zeqir Mulaku qiramarrës i lokalit nr.142
- 1.5. Naim Jetullahu qiramarrës i lokalit nr.144

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

3. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi



Kryesuese e Kuvendit



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRAN	
01 Nr. / Br	36/25
Nr. i fq. / Br. st	- 1 -
Data: / Datum	27. 02. 2025
VUSHTRRI - VUČITRAN	



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja "d" të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenin nenit 19, paragrafi 1 pika 1.4 i Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më **27 shkurt 2025**, merr këtë:

VENDIM PËR APROVIMIN E RAPORTIT TË VLERËSIMIT TË DËMEVE

1. Me këtë vendim aprovet raporti i Komisionit Komunal lidhur me Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera, në Komunën e Vushtrrisë, për muajt: korrik dhe gusht 2024.
2. Komisioni Komunal për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera, ka dalë në terren dhe ka bërë evidentimin e dëmeve të shkuara nga moti i ligë (erërat e forta, breshëri dhe zjarret,), që kanë mbretëruar në periudhën e sipër-cekur, në Komunën e Vushtrrisë.
3. Komisioni i cekur më lartë, ka bërë vlerësimin e dëmeve dhe ka shqyrtuar kërkesat e qytetarëve, dhe konform të gjeturave ka evidentuar dhe kalkuluar shumat e mjeteve financiare në vlerë totale prej **13,005.30 €**, si në të mbjellat bujqësore e po ashtu edhe dëmet e shkuara në ekonomitë familjare dhe këto të dhëna për dëmet janë të bashkangjitura në mënyrë tabelare në raportin e komisionit.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Raporti i Komisionit Komunal për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera, në Komunën e Vushtrrisë.
5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim e Komunës së Vushtrrisë dhe po ashtu ky vendim i dërgohet edhe Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave (AME).
6. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi



Kryesuese e Kuvendit